

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. _____ Prot.
Tiranë, më _____ .2016

REPubLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIREQENIES SOCIALE
DHE RINISE

MINISTRI

Nr. 1324 Prot.
Tiranë, më 03.03.2016

U DH Ë Z I M

Nr. 6 Datë 03.03.2016

PËR
ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26 dhe nenit 51, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13 të ligjit nr. 8872, datë 29.03.2002 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Lëndët e provimeve të maturës shtetërore profesionale për vitin shkollor 2015-2016, janë:
 - a. Provime të detyruara:
 - Gjuhë shqipe dhe letërsi (D1)
 - Matematikë (D2)
 - Gjuhë e huaj (D3)
 - b. Provimi me Zgjedhje të Detyruar
 - Teori profesionale e integruar, sipas Drejtimit/Profilimit përkatës.
 - c. Provimi me Zgjedhje
 - 1.1 Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën që në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor B1.
 - 1.2 Gjuhët e huaja që jepen provim i detyruar D3 janë Anglisht, Italisht, Frëngjisht dhe Gjermanisht.
Preferenca e maturantit për këtë provim pasqyrohet në Formularin A1/A1Z.
Maturanti i vitit të kaluar që ka rezultuar mbetës në provimin e detyruar D3 duhet të rijapë atë.

Kandidati që aplikon me A1Z, nuk i nënshtrohet provimit të detyruar D3.

2. Provime me zgjedhje

2.1 Lista e lëndëve të provimeve me zgjedhje është:

Nr.	Lënda	Kredite
I. Lëndët me zgjedhje të lirë		
1.	Gjuhë e huaj	10
2.	Kimi	4
3.	Fizikë	4
4.	Biologji	4
5.	Histori	5
6.	Gjeografi	5
7.	Ekonomi	2
8.	Qytetari	3
II. Teori profesionale e integruar me zgjedhje të detyruar		
1.	Administrim biznesi	8
2.	Agrobiznes	8
3.	Elektronikë në teknologjinë e automatizimit (pilot PEM)	8
4.	Bujqësi	8
5.	Elektronikë	8
6.	Elektroteknikë	8
7.	Gjeodezi	8
8.	Hoteleri-Turizëm	8
9.	Instalues i Sistemeve Termohidraulike	8
10.	Llogari	8
11.	Mbështetje e përdoruesve të TIK	8
12.	Mekanikë	8
13.	Ndërtim	8
14.	Përpunim druri	8
15.	Rrjete të dhënash	8
16.	Shërbime bankare	8
17.	Shërbime mjetesh transporti	8
18.	Shërbime sociale dhe shëndetsore	8
19.	Silvikulturë	8
20.	Sipërmarrje e agjencisë turistike	8
21.	Teknologji ushqimore	8
22.	Tekstil-konfeksione	8
23.	Veterinari	8
24.	Harry Fultz - Automekanik	8
25.	Harry Fultz - Biznes	8
26.	Harry Fultz - Elektronikë	8

2.2 Testi i gjuhës së huaj me zgjedhje, hartohet në nivelin gjuhësor B2.

2.3 Lista e gjuhëve të huaja, si lëndë me zgjedhje, përcaktohet në udhëzimin për plotësimin e formularit A1/A1Z.

- 2.4 Programet orientuese të lëndëve të detyruara (Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj) dhe të provimit me zgjedhje të detyruar (Teori profesionale e integruar), për maturantët/kandidatët e shkollave profesionale, janë në përshtatje me programet ekzistuese të shkollave profesionale.
- 2.5 Programet orientuese të grupit të lëndëve me zgjedhje “Lëndët me zgjedhje të lirë”, janë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z, përfshirë dhe maturantët/kandidatët e shkollave profesionale.
- 2.6 Lënda "Gjeografi" (bërthamë dhe e thelluar), përmban edhe lëndën "Shkenca e tokës".
3. Nga lista e lëndëve me zgjedhje, maturanti/kandidati i shkollave profesionale zgjedh:
- Lëndën e parë, nga grupi i lëndëve “II. Teori profesionale e integruar me zgjedhje të detyruar”, sipas drejtimit/profilit që ka ndjekur në shkollë.
 - Lëndën e dytë, nga grupi i lëndëve “I. Lëndët me zgjedhje të lirë”.
4. Kandidatit, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50, (nota 5), i njihen dhe nuk i rijep ato.
5. Kandidati, i cili
- a. rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale, e rijep atë për t’u pajisur me diplomën e maturës;
 - b. nuk ka dhënë provimet me zgjedhje ose nuk ka rezultuar kalues, por është pajisur me dëftesë pjekurie, i rijep ato në përputhje me këtë Udhëzim.
6. Kandidati, i cili, në Maturën Shtetërore 2012 ka zgjedhur për të dhënë 3 (tri) provime me zgjedhje dhe:
- a. ka rezultuar mbetës në dy prej tyre, zgjedh vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje sipas këtij Udhëzimi;
 - b. rezulton kalues në dy prej tyre, pajiset me diplomën e maturës.
7. Kandidati i pajisur me dëftesë pjekurie para vitit 2006, i cili dëshiron të aplikojë për studime universitare, i njihen provimet e detyruara që përputhen me D1 dhe D2 ose provimet e njëvlefshme me to, të njësuara nga DAR/ZA, por duhet t’i nënshtrohet edhe provimeve me zgjedhje mbështetur në këtë Udhëzim.
8. Provimi shkollor i Teorisë Profesionale të Nivelit të III-të, të Arsimit Profesional nuk zhvillohet. Provimet e tjera të Teorisë dhe Praktikës Profesionale, në Nivelin I dhe II, si dhe provimi i Praktikës Profesionale në Nivelin III, zhvillohen nga shkollat profesionale, si më parë.
9. Për realizimin e Maturës Shtetërore Profesionale zbatohet Rregullorja e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR
LINDITA NIKOLLA

MINISTËR
BLENDI KLOSI

